



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 45 Datë 22.05.2018

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	Bashkia Belsh
Hetim administrativ, iniciuar nga	• APP x • Reklamim nga të tretët
Numri i procedurave të audituara	1
Lloji i procedurës/ave të audituara	Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës,
Konstatimet kryesore	• Nga shqyrtimi i gjithë informacionit të administruar, në kuadër të hetimit administrativ, Agjencia e Prokurimit Publik konstatoi se, autoriteti kontraktor nuk ka justifikuar përdorimin e procedurës së prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, gërma “b”, të ligjit të prokurimit publik, së cilës i është referuar në përzgjedhjen e kësaj lloji procedure. • AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të ligjit të prokurimit publik. • Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar kriteret e veçanta të pranimit, të hartuara për procedurën e prokurimit në fjalë.
Masat e marra	Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të nenit 13, pika 2 gërma “i” dhe nenit 72, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), vendosi

	të penalizojë me gjobë 4 (katër) persona, konkretisht: - Titullarin e autoritetit kontraktor, - Tre persona ne cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.
--	---